



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:158996
Datë: 17.03.2025
Numri i dokumentit: 06999112

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.38/2011

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- Departamenti për Krime të Rënda, (në Objektivin e Gjykatës në Mitrovicë - Veri), Kryetari i trupit gjykues, Gjyqtari Avni Mehmeti, me anëtarët e trupit gjykues – gjyqtarët Bekim Veliqi dhe Xhemajl Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Tahiri, procesmbajtësen Edita Kelmendi-Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit Asllan Ferati, i akuzuar për veprën penale vrasje në tentativë nga neni 146 i lidhur me nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës (më tej KPK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në PTH nr. 38/2011, datë 13.07.2011. Në këtë rast, shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në prani të palëve: Prokurorit të shtetit në PTH në Mitrovicë, Fetije Bajrami, të pandehurit Asllan Ferati, mbrojtëses së tij, av. Fatmire Braha, dhe të dëmtuarit I.F. Seanca e shqyrtimit gjyqësor është regjistruar në procesverbal, dhe është incizuar me audio si dhe ka qenë e hapur për publikun. Shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar më datë 27.02.2025. Të njëjtën ditë, Gjykata ka shpallur publikisht aktgjykimin. Ndërsa më datë 17.03.2025, është përpiluar me shkrim ky;

A K T G J Y K I M

- Kundër të pandehurit:

ASLLAN FERATI nga i ati dhe e ëma (më parë), (data e lindjes) në fshatin V..... të komunës së M.....s, me vendbanim të përhershëm në fshatin, komuna e M....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i papunë, i pamartuar, ka përfunduar shkollën e mesme teknike – drejtimi i xehetarisë, është në gjendje të varfër ekonomike, shfrytëzues i ndihmës sociale, me numër personal ID:, më parë i dënuar, të njëjtin;

SHPALLET FAJTOR

Sepse:

Më datën 09.04.2011, rreth orës 13:15, në Mitrovicë, në parkun e qytetit, në vendin e quajtur ".....", afër Qendrës së Kulturës, i pandehuri ka tentuar me dashje ta privojë nga jeta të

dëmtuarin, I.F. Fillimisht, i pandehuri e ka ftuar të dëmtuarin me telefon dhe e ka lutur që të takohen në park për të biseduar rreth një mosmarrëveshjeje që kishin mes tyre. Posa kanë arritur në park dhe gjatë bisedës, përnjëherë, i pandehuri ka nxjerrë një thikë patentë nga xhepi me teh prej 10 cm dhe duke e shtrënguar për jelekun e të dëmtuarit me dorën e tij të majtë, kurse me dorën e tij të djathtë e godet tri herë të dëmtuarin në pjesë vitale të trupit (pjesën e epërme të gjoksit, nën sqetulla, dhe brinjë) dhe pas përpjekjeve për të shpëtuar, i dëmtuari arrin të largohet nga i akuzuari dhe kërkon ndihmë nga dy policë që kanë qenë aty afër, të cilët e dërgojnë në Spitalin e Emergjencës në Mitrovicë. Sipas ekspertizës mjeko-ligjore, i dëmtuari ka pësuar tri plagë dhe dëmtime në kafaz- abdomen, krahun e djathtë si dhe nën sqetullën e majtë, të shkaktuara nga një mjet me majë (thikë). Këto dëmtime kanë rezultuar me dëmtim të përkohshëm të shëndetit të tij.

- Me këtë, ai ka kryer veprën penale Vrasje në tentativë, sipas nenit 146, lidhur me nenin 20 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
- Gjykata, në mbështetje të nenit 1, 2, 3, 6, 11, 20, 31, 32, 33, 34, 36, 38, 64, 65, 66, 67 dhe nenit 146 të KPK-së dhe nenit 449, 450 dhe nenit 460 të KPP-së, të pandehurit Asllan Ferati, i;

SH Q I P T O N

- I. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në këtë dënim, i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 09.04.2011 deri më 04.05.2011, si dhe në masën e arrestit shtëpiak, nga data 04.05.2011 deri më 23.06.2011.
- II. OBLIGOHET i pandehuri, Asllan Ferati, që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, 50 (pesëdhjetë) euro për taksën në Fondin për kompensimin e viktimave të krimit, si dhe për ekspertizën mjeko-ligjore, shumën prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro. Të cilat obligohet t'i paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- III. Pala e dëmtuar ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.
- IV. Në mbështetje të nenit 276 par.1 të Kodit të Procedurës Penal të Kosovës, URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i sendit (thikës), i cili është sekuestruar nga i pandehuri Asllan Ferati.

Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ky send duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

A r s y e t i m

- Aktakuza;

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP.nr.38/2011, datë 13.07.2011, kundër të akuzuarit Asllan Ferati, për veprën penale "vrasje në tentativë", sipas nenit 146 të lidhur me nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës.

- Kompetenca;

Sipas nenit 1, paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatat, Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Sipas nenit 9, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7 i këtij Ligji thekson se Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajt dhe Vushtrrisë.

Bazuar në aktakuzën e ngritur, vepra penale e vrasjes në tentativë, ka ndodhur në M..... dhe rrjedhimisht, bien brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, sipas nenit 29, paragrafi 1, i KPP-së. Sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo natyrë e veprave penale për të cilën akuzohet i pandehuri, sipas nenit 22 par. 1, nën paragrafi 1.1, dhe nën paragrafi 1.2 pika 1.2.54 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), hynë në kompetencë të Departamentit për krime të rënda.

- Rrjedha e procedurës;

Më datë 03.10.2011, në këtë çështje është mbajtur seanca për konfirmimin e aktakuzës, në prezencën e të gjitha palëve.

Gjatë seancës për konfirmimin e aktakuzës, i pandehuri Asllan Ferati e ka mohuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Me aktvendimin KA.nr.89/11, të datës 03.10.2011, të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, është konfirmuar aktakuza e Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë PP.nr.38/11, e datës 12.07.2011, ndaj të pandehurit Asllan Ferati, për shkak të veprës penale "vrasje në tentativë" nga neni 142 i lidhur me nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës.

I pandehuri Asllan Ferati për këtë rast ka qëndruar nën masën e paraburgimit nga data 09.04.2011 deri më 04.05.2011, dhe në masën e arrestit shtëpiak nga data 04.05.2011 deri më 23.06.2011.

Shqyrtimi gjyqësor;

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në prezencën e Prokurorit të shtetit në PTH në Mitrovicë, Fetije Bajrami, të pandehurit Asllan Ferati, mbrojtëses së tij, avokatës Fatmire Braha, dhe të dëmtuarit I.F.

- Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor;

Seanca e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje është mbajtur më datën 27.02.2025. Kjo seancë ka qenë e hapur për publikun.

- Regjistrimi i seancave;

Gjithë rrjedha e shqyrtimit gjyqësor është regjistruar me shkrim në procesverbal, si dhe është regjistruar me audio-incizim. Palët nuk kanë paraqitur asnjë vërejtje në përmbajtjet e procesverbalit dhe incizimit të seancës. Pas seancës, palëve u është dhënë nga një kopje e procesverbalit.

- Provat e administruara;

Në cilësi të provave, gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruar, provat e propozuara në aktakuzë nga prokurori i shtetit në PTH në Mitrovicë, provat e propozuara nga palët si dhe ato që janë nxjerr zyrtarisht nga gjykata.

- Dëgjimi i dëshmitarëve;

Më 27 shkurt 2025, gjatë shqyrtimit gjyqësor në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar i dëmtuari; I.F.

- Provat materiale të administruara;

Në cilësi të provave materiale në shqyrtimet gjyqësor të datës 27.02.2025 janë administruar;

- Dosja nr....., dt.10.04.2011.
- Raportet e oficerëve policor dt.09.04.2011.
- Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes dt.09.04.2011 nga Njësia e Forenzikës si dhe fotoalbumi nga vendi i ngjarjes.
- Fletë lëshimi nga QKUK- Klinika e Kirurgjisë Torokale e QKUK Prishtinë me nr.....e dt.19.04.2011.
- Raporti i ekspertizës mjeko ligjore (super ekspertizë) dt.05.02.2025.

- Marrja në pyetje e të pandehurit;

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 27.02.2025, i pandehuri Asllan Ferati, e ka shfrytëzuar të drejtën e tij dhe është mbrojtur në heshtje.

- Fjala përfundimtare;

Më 27 shkurt 2025, palët e kanë paraqitur fjalën përfundimtare.

- Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor dhe shpallja publike e aktgjykimit;

Më 27 shkurt 2025, gjykata e ka shpallur të përfunduar shqyrtimin gjyqësor. Të njëjtën ditë, Gjykata e ka shpall publikisht aktgjykimin në prezencën e të pandehurit, mbrojtëses së tij dhe palës së dëmtuar.

- Përmbajtja e fjalës përfundimtare;

Prokurorja e shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Fetije Bajrami, në fjalën përfundimtare, të cilën e ka dorëzuar në formë të shkruar, ka theksuar se, pas administrimit të provave, në mënyrë bindëse është vërtetuar se i pandehuri Asllan Ferati ka kryer veprën penale "vrasje në tentativë" nga neni 146 i lidhur me nenin 20 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Pas dëgjimit të palës së dëmtuar dhe pas administrimit të provave materiale, pa mëdyshje është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Nga deklarata e të dëmtuarit dhe dëshmitarit I.F, rezulton se i pandehuri, ditën kritike, e ka ftuar në telefon dhe kanë shkruar te parku "....." dhe kanë filluar të bisedojnë. Kur për një moment, i pandehuri ka nxjerrë thikën dhe e ka goditur disa herë me goditje të njëpasnjëshme. I dëmtuari ka arritur të largohet nga vendi dhe e ka lajmëruar policinë.

Tutje, është shtuar se, nga fletë lëshimi në emër të dëmtuarit I.F, është konstatuar se ai ka pësuar lëndime nga mjeti i mprehtë (thikë) në regjionin e gjoksit djathtas dhe në regjionin e krahut majtas, me tri plagë të ndryshme, me gjerësi 1-2 cm dhe thellësi 3-4 cm. I është shkaktuar dëmtim i diafragmës, ku i dëmtuari ka qëndruar edhe në spital. Ndërsa, nga ekspertiza mjeko-ligjore në emër të dëmtuarit, rezulton se të njëjtit i janë shkaktuar tri plagë me dëmtime në pjesën e kafazit, abdomenit, në krahun e djathtë dhe në sjetullën e majtë, të shkaktuara nga mjeti i cili posedon maje, në këtë rast thika. Këto dëmtime kualifikohen si dëmtime të rënda trupore, me pasoja të përkohshme të shëndetit. Nga të gjitha këto, Prokurorja ka propozuar gjykatës që të marrë parasysh rrethanat rënduese në këtë rast dhe ato bazuar në normat ligjore të ligjeve pozitive dhe dispozitat ligjore të KELDNJ, ku garantohet dhe mbrohet me ligj e drejta për jetë. Ajo theksoi

se i pandehuri, me dashje dhe duke qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij dhe pasojat, ka dëshiruar dhe ka planifikuar kryerjen e veprës penale, duke e thirrur të dëmtuarin dhe duke përdorur mjetin (thikën) për kryerjen e veprës penale, me të cilën e ka goditur disa herë. Po ashtu, ka theksuar se ekziston një aktgjykim dënues për të pandehurin për veprën penale "Vrasje" nga neni 146 të KPK-së, dhe i njëjti ka vuajtur dënimin. Krejt në fund, Prokurorja ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

I dëmtuari I.F në fjalën përfundimtare e ka përkrahur fjalën përfundimtare të Prokurorit të shtetit, ndërsa, nuk ka paraqit fjalë përfundimtare.

Mbrojtësja e të pandehurit Asllan Ferati, av. Fatmire Braha, në fjalën përfundimtare ka theksuar se nga provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk është arritur të vërtetohet se i pandehuri Asllan Ferati ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Gjithashtu, nuk është arritur të vërtetohet dashja e kryerjes së veprës penale të vrasjes në tentativë, si element crucial i veprës penale. Sipas mbrojtjes, fakt kontestues në këtë çështje ishte nëse i pandehuri Asllan Ferati ka pasur qëllim dhe dashje për ta privuar nga jeta të dëmtuarin.

Vepra penale e vrasjes nënkupton ndërmarrjen e veprimeve direkte apo indirekte me qëllim, me dashje të shkaktimit të pasojës — privimit nga jeta të personit. Kryesi përgjigjet penalisht për veprën penale të vrasjes në tentativë nëse ekziston lidhja shkakore ndërmjet veprimit dhe pasojës së shkaktuar. Tutje, ka shtuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor, i dëmtuari ka deklaruar se kur është goditur nga i pandehuri, ai nuk ka qenë mirë psiqikisht dhe se i njëjti ka deklaruar se nuk kërkon kompensim dëmi dhe se me të pandehurin janë pajtuar. Nga të gjitha këto, ka konsideruar se në veprimet e të pandehurit Asllan Ferati përmbushen elementet e veprës penale të lëndimit të rëndë, pasi, sipas deklaratës së të dëmtuarit, gjatë gjithë kohës kanë qenë shumë afër, ashtu që, po të ekzistonte dashja e të pandehurit për ta privuar nga jeta, ai ka pasur mundësi ta kishte bërë. Por që tek i pandehuri nuk ka ekzistuar dashja për ta privuar nga jeta tani të dëmtuarin.

Krejt në fund, i ka propozuar gjykatës që të marrë parasysh faktin se nga ndodhja e këtij rasti kanë kaluar 14 vjet, pendimi i të pandehurit dhe se i pandehuri nuk ka pasur qëllim dhe dashje për ta privuar nga jeta të dëmtuarin, se me të dëmtuarin janë pajtuar dhe se nuk ekziston rreziku i përsëritjes së ndonjë veprimi inkriminues. Nga këto, i ka propozuar gjykatës që t'i shqiptojë një dënim sa më të butë.

I pandehuri Asllan Ferati, në fjalën përfundimtare, e ka përkrahur fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij, ndërsa nuk ka paraqitur fjalë përfundimtare.

- Aktakuza e prokurorisë;

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit Asllan Ferati për veprën penale të vrasjes në tentativë, sipas nenit 142 të Kodit Penal të Kosovës, e lidhur me nenin 20 të këtij Kodi.

I pandehuri, Asllan Ferati, që nga fillimi i procedurës penale ka mohuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së prokurorisë. Ai ka pretenduar se i dëmtuari kishte dalë me të dashurën e tij dhe, ditën kritike, nuk ka pasur as dashje dhe as qëllim për ta privuar nga jeta. Sipas tij, ai ka dalë me të dëmtuarin vetëm për të biseduar, por gjatë bisedës ka humbur kontrollin dhe e ka goditur me thikë.

Mbrojtësja e të pandehurit, avokate Fatmire Braha, ka kundërshtuar akuzën e prokurorisë në lidhje me të pandehurin. Sipas saj, prokuroria nuk ka arritur të provojë dashjen e të pandehurit për të kryer veprën penale për të cilën akuzohet, pasi qëllimi i të pandehurit nuk ka qenë që ta privojë nga jeta të dëmtuarin.

- Faktet jo kontestuese:

I pandehuri, Asllan Ferati, është njohur edhe më parë me të dëmtuarin, I.F, pasi ata kanë lidhje gjaku dhe janë kushërinj mes veti. Si rezultat i kësaj afërsie, para ngjarjes, i pandehuri dhe i dëmtuari kanë pasur raporte shumë të mira mes tyre.

Pak kohë para ngjarjes, ka lindur një mosmarrëveshje mes të pandehurit dhe të dëmtuarit, ku i pandehuri dyshonte se i dëmtuari kishte ndërhyrë në lidhjen e tij me një vajzë. Ky dyshim ka quar në përkeqësimin e raporteve mes tyre. Mosmarrëveshjet kanë vazhduar për një kohë të gjatë, pavarësisht se i dëmtuari kishte sqaruar se nuk kishte asnjë lidhje me vajzën që i pandehuri pretendonte.

Në ditën kritike, i pandehuri e kishte ftuar të dëmtuarin dhe ishin takuar në qytet dhe më pas kishin shkuar në parkun e qytetit. Derisa kishte qëndruar në park, i pandehur e kishte akuzuar të dëmtuarin se gjoja po mbante lidhje me vajzën me të cilën ai është në lidhje. Dhe gjatë diskutimit, i pandehuri, pa paralajmërim, e ka nxjerrë thikën dhe e ka goditur disa herë të dëmtuarin në pjesët vitale të trupit.

Palët në këtë rast nuk i kanë kontestuar faktet dhe gjetjet, siç janë paraqitur më lart. Kjo do të thotë se ato janë pranuar nga të dyja palët si të sakta dhe të vërteta, dhe kështu, nuk ka pasur ndonjë kundërshtim mbi ngjarjen që ka ndodhur. Përveç kësaj, faktet e paraqitura vërtetohen në mënyrë të detajuar përmes dëshmive të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Një nga dëshmitë kryesore është ajo e të dëmtuarit, i cili ka dhënë një rrëfim të detajuar gjatë seancës gjyqësore, duke shpjeguar rrethanat e ngjarjes dhe dëmtimet që ka pësuar. Dëshmia e tij ka qenë shumë e rëndësishme për të vërtetuar ngjarjen, pasi ka pasur një ndikim të dukshëm në formimin e njohurive të gjykatës lidhur me mënyrën si ka ndodhur sulmi.

- Faktet e vërtetuara;

Më datën 09.04.2011, rreth orës 13:15, i pandehuri, Asllan Ferati, përmes telefonit e kishte ftuar të dëmtuarin për një takim. Ata ishin takuar në qytet dhe më pas kishin shkuar në parkun e qytetit, me kërkesën e të pandehurit. Gjatë qëndrimit të tyre atje, i pandehuri e kishte akuzuar të dëmtuarin se po mbante lidhje me një vajzë, me të cilën ai kishte pasur një lidhje më parë. Derisa bisedonin, i pandehuri, pa asnjë paralajmërim, kishte nxjerrë thikën dhe e kishte goditur të dëmtuarin tri herë, duke i shkaktuar lëndime trupore.

I dëmtuari, duke tentuar të mbrohet, kishte arritur të largohej dhe të ikte nga vendi i ngjarjes. Pastaj kishte arritur deri te Ura e Ibrit, ku kishte takuar dy zyrtarë policorë. I dëmtuari i kishte njoftuar ata për ngjarjen, të cilët pastaj e kishin dërguar të dëmtuarin në Qendrën Shëndetësore në Mitrovicë për të marrë ndihmë mjekësore. Si pasojë e sulmit me thikë, i dëmtuari kishte pësuar lëndime trupore. Ai kishte pësuar tri plagë; dëmtime në kafazin e abdomenit, krahun e djathtë, si dhe nën sqetullën e majtë, të shkaktuara thikë.

Sa i përket motivit të sulmit, gjykata ka vlerësuar se i pandehuri kishte dyshuar se i dëmtuari kishte krijuar një lidhje me një vajzë me të cilën shkonte edhe i pandehuri. Megjithatë, përveç si pretendim, nuk ka pasur asnjë fakt që do ta dëshmonte këtë. Gjkata nuk është marrë më shumë me këtë çështje për ta vërtetuar, pasi ajo nuk ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Fakti se i pandehuri e ka sulmuar të dëmtuarin me thikë, dëshmohet qartë dhe në mënyrë të plotë nga dëshmia e të dëmtuarit, e cila është dëgjuar si dëshmitar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

I dëmtuari, I.F, në dëshminë e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka theksuar se i akuzuari është kushëriri i tij i afërt dhe se para këtij rasti ata janë shoqëruar vazhdimisht së bashku. Sipas tij,

pak para kësaj ngjarjeje, i pandehuri e kishte akuzuar për ndërhyrje te një vajzë, me të cilën Asllani (i pandehuri) kishte qenë në lidhje.

Sipas dëshmisë së tij, ditën e ngjarjes, Asllani e kishte telefonuar dhe ata ishin takuar në qytet. Më pas, i pandehuri i kishte sygjëruar që të shkonin në parkun e qytetit. Kur kishin arritur atje, i pandehuri e kishte hapur përsëri temën e vajzës dhe e kishte akuzuar se po ndërhynte në jetën e tij dhe te ajo vajza me të cilën ai ishte në lidhje. Dëshmitari – i dëmtuari ka thënë se i ka shpjeguar Asllanit se nuk ka asnjë lidhje dhe asnjë kontakt me vajzën për të cilën ai po pretendon.

Dëshmitari gjithashtu ka thënë se, derisa bisedonin me Asllanin, në një moment ai e kishte kapur me njëren dorë për rrobave, ndërsa me dorën tjetër, e kishte goditur me thikë disa herë në pjesën e përparme të trupit. Më pas ka tentuar të mbrohet dhe për një moment ka arritur të largohet nga i pandehuri, duke shkuar në drejtim të Urës së Ibrit, ku ka takuar dy zyrtarë policorë, të cilët i kanë njoftuar për ngjarjen dhe pastaj e kanë dërguar në Qendrën Shëndetësore për ndihmë.

Gjithashtu, faktet e lartpërmendura vërtetohen edhe nga dëshmitë dhe provat materiale, të cilat do t'i paraqesim dhe elaborojmë si në vijim.

Nga dosja dhe raporteve me nr..... e datës 10.04.2011, vërtetohet se më datën 09.04.2011, në parkun e qytetit, afër urës kryesore në Mitrovicë, ka ndodhur një therje me thikë dhe për këtë janë ndërmarrë veprimet përkatëse. Konkretisht, është fotografuar vendi i ngjarjes, pamjet e njollave të gjakut të evidentuara me numra rendorë nga D#1 deri në D#15. Po ashtu, me dëshminë D#16 është fotografuar thika, e cila dyshohet se është përdorur nga i pandehuri Asllan Ferati.

Sipas raporteve të zyrtarëve policorë të datës 09.04.2011, vërtetohet se më 09.04.2011, një person kishte kërkuar ndihmë pranë Urës së qytetit në Mitrovicë. Sipas raportit, personi i therur me thikë ka qenë I.F, dhe si rezultat i kësaj, kishte pasur gjakderdhje. I dëmtuari gjithashtu kishte njoftuar se ishte goditur nga kushëriri i tij, Asllan Ferati. Raporti shton se i dëmtuari ishte dërguar në spitalin e urgjencës, dhe sipas mjekut kujdestar, V.P, me pastaj i dëmtuari ishte dërguar për mjekim në QKUK Prishtinë. Krejt në fund, në raport theksohet se policia e kishte arrestuar të dyshuarin, Asllan Ferati, lidhur me këtë rast. Po ashtu, mjeti që ishte përdorur për kryerjen e veprës penale (thika) ishte sekuestruara nga policia.

Ndërsa, nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, datë 09.04.2011, nga Njësia e Forenzikës, si dhe fotoalbumi nga vendi i ngjarjes, vërtetohet se, rreth orës 13:20 minuta, policia ishte njoftuar

për një rast therjeje të një personi me thikë që kishte ndodhur në afërsi të shtëpisë së kulturës “R.M” në Mitrovicë. Sipas raportit, në vendin e ngjarjes kishte njolla të kuqe, të dyshuara të jenë gjak. Ndërsa, evidentohet se të dyshuarit Asllan Ferati i është konfiskuar një mjet i mprehtë, i cili kishte njolla të kuqe gjaku.

Gjithashtu nga fletë-lëshimi nga QKUK – Klinika e Kirurgjisë Torakale e QKUK Prishtinë, me nr....., datë 19.04.2011, vërtetohet se i dëmtuari I.F ishte pranuar në këtë repart nga Qendra Emergjente si transfer nga Spitali Regjional i Mitrovicës, për shkak të sulmit me mjet të mprehtë (thikë) në regjionin e gjoksit – pektoral djathtas dhe në regjionin e krahut majtas. Me konstatimin se pacienti ka arritur në Qendrën Emergjente me dhimbje në gjoks, sidomos në anën e djathtë, dhe me vështirësi në frymëmarrje.

Ndërkaq, sipas raportit të ekspertizës mjeko-ligjore të datës 05.02.2025, i cili është bazuar në dokumentacionin mjekësor nga QKUK-QE me nr....., si dhe raportin e fletë-lëshimit për kurim në spital në QKUK – Klinika e Kirurgjisë Torakale, me nr....., datë 19.04.2011, është konstatuar se, bazuar në diagnozat e dhëna, rezulton se i dëmtuari ka pësuar plagë shpuese në regjionin torako-abdominal të anës së djathtë, plagë punktuese-pretëse në regjionin e krahut të djathtë dhe në nënsqetullën e majtë. Këto lëndime dhe plagë kualifikohen si dëmtime të rënda trupore, por jo të rrezikshme në momentin e shkakimit. Për më tepër, duke qenë se nuk ka dokumentacion për vazhdimin e kurimit apo komplikimeve (pasi rasti ka ndodhur në vitin 2011), ato shoqërohen me dëmtime të përkohshme për shëndetin e tij. Pra, sipas këtij raporti, konstatohet gjithsej 3 plagë-dëmtime: në pjesën e kafazit të kraharorit, abdomenit, në krahun e djathtë, si dhe në nënsqetullën e majtë, të shkaktuara nga një mjet që posedon maje dhe teh (thikë).

Edhe i pandehuri, në deklaratën e tij të dhënë në prokurori, pohon se ditën kritike është takuar me të dëmtuarin dhe nuk e ka mohuar se e ka sulmuar me thikë. Lidhur me këtë, ai ka theksuar: "Ditën kritike e kam ftuar në telefon I..... dhe i kam thënë hajde të shkojmë të bisedojmë për këtë problem. Jemi takuar dhe unë kam propozuar të shkojmë në automjetin e tij dhe me marrëveshje kemi shkuar te Shtëpia e Kulturës për të biseduar aty. I kam thënë, pse po del me atë vajzën, dhe ai u përgjigj se jo. Pastaj i kam thënë, ‘të kanë parë njerëzit,’ dhe gjatë bisedës ai e shtinte dorën nën sqetull. Atëherë e kam nxjerrë thikën me patent dhe e kam humbur kontrollin dhe kam filluar ta godas, por nuk e di se ku. Pas kësaj, jemi ndarë. Sipas të pandehurit, ai ka qenë

disa vite në një lidhje me një vajzë për qëllime martesë, por i dëmtuari kishte ndërhyrë në këtë lidhje, dhe kjo ka qenë arsyeja e problemit që ka ndodhur me të dëmtuarin.

Prandaj nga provat e theksuara me lartë, përtej çdo dyshimi, është vërtetuar se ditën kritike, i pandehuri e kishte sulmuar me thikë tri herë të dëmtuarin duke e goditur në pjesën e kafazit të kraharorit- abdomenit, në krahun e djathtë, si dhe në nënsqetullën e majtë, si pasojë e këtij sulmi i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore me qëllimin për ta privuar nga jeta.

Gjykata gjen se në veprimet e të pandehurit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale të vrasje në tentativë nga nenit 142 e lidhur me nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës. Veprimet e të pandehurit, përkatësisht sulmi me thikë ndaj të dëmtuarit, qartë dëshmojnë dashjen e tij për ta privuar nga jeta të dëmtuarin. Sipas provave të administruara, është e qartë se veprim i të pandehurit ka qenë i qëllimshëm, duke vepruar me dashje direkte ose të drejtpërdrejtë për të shkaktuar dëmtim të rëndë fizik dhe për të privuar nga jeta të dëmtuarin.

Provat e rastit dëshmojnë pa dyshim se i pandehuri ka qenë plotësisht i vetëdijshëm për pasojat e veprimeve të tij. Ai ka qenë në dijeni se sulmi dhe goditjet me thikë ndaj të dëmtuarit mund të shkaktojnë pasoja të paparashikueshme dhe të rrezikojnë jetën e tij. Kjo është dëshmuar nga fakti se i pandehuri ka goditur disa herë të dëmtuarin në pjesët vitale të trupit dhe ka vazhduar me sulmin, duke tentuar të shkaktojë pasoja të tjera serioze. I pandehuri ka vazhduar sulmin derisa i dëmtuari ka arritur të largohet, çka tregon se ai ka vepruar me qëllim të qartë dhe të ndërgjegjshëm për të privuar të dëmtuarin nga jeta dhe për të realizuar qëllimet e tij.

Gjithashtu i pandehuri ishte përgatitur për sulmin ndaj të dëmtuarit. Para ngjarjes, ai e kishte ftuar të dëmtuarin për një takim me qëllim që ta mashtronte dhe ta bënte të qëndronte në një vend të përshtatshëm për realizuar sulmin. Ditën kritike, i pandehuri kishte kontaktuar të dëmtuarin përmes telefonit dhe e kishte ftuar që të shkonte në parkun e qytetit, një vend i zgjedhur për të realizuar planin e tij. Ky veprim dëshmon qartë se i pandehuri ka pasur një qëllim të qartë për të sulmuar të dëmtuarin dhe e ka përgatitur rastin që më parë.

Në anën tjetër, i pandehuri për sulmin kishte përzgjedhur dhe përdorur thikën si një mjet të shumë i rrezikshëm. I pandehuri ka qenë i vetëdijshëm se thika është një mjet i rrezikshëm, që mund të shkaktojë lëndime të rënda dhe pasojat fatale për jetën e të dëmtuarit. Kjo tregon se ai ka pasur një vëmendje të plotë për mundësinë e shkaktimit të pasojave të rënda ndaj të dëmtuarit.

Pavarësisht këtyre rreziqeve, ai ka vazhduar veprimet e tij, përkatësisht sulmin me thikë, me qëllimin për ta privuar nga jeta të dëmtuarin.

Sipas provave të administruara, i pandehuri ka qenë plotësisht i aftë mendërisht për të kuptuar veprimet dhe sjelljet e tij dhe për t'i kontrolluar ato. Ai ka planifikuar veprimet e tij në mënyrë të detajuar, siç janë ftesa për të dëmtuarin, zgjedhja e vendit dhe pajisja me mjetin e përshtatshëm – thikën. Ai ka pasur dijeni të plotë për pasojat që mund të shkaktonte përdorimi i thikës, duke përfshirë rrezikun për jetën e të dëmtuarit, dhe megjithatë ka vazhduar me sulmin, duke vepruar me qëllim të qartë për të privuar të dëmtuarin nga jeta dhe për të realizuar qëllimet e tij.

Për më tepër, i pandehuri e kishte sulmuar disa herë me thikë të dëmtuarin dhe kishte tentuar të vazhdonte sulmin ndaj tij. Megjithatë, i dëmtuari kishte arrit të mbrohej dhe të largohej nga i pandehuri, duke mos lejuar që ai të vazhdonte më tej sulmin dhe duke i shpëtuar pasojave fatale. Ky fakt tregon se, pavarësisht qëllimit të pandehurit për të vazhduar sulmin, i dëmtuari arriti të shpëtonte dhe të largohej nga vendi i ngjarjes. Gjithashtu, i pandehuri e ka sulmuar dhe goditur të dëmtuarin disa herë me thikë në pjesët më vitale të trupit. Kjo tregon qartë dashjen e tij të shprehur, pasi që në pjesët ku e ka goditur të dëmtuarin ndodhen organet vitale të trupit të njeriut, siç janë zemra, mëlçia dhe pjesë të tjera jetike.

Në përfundim, gjykata konstaton se veprimet e të pandehurit përmbushin të gjitha elementet e veprës penale të vrasjes në tentativë. Meqenëse veprimet kanë qenë të qëllimshme dhe ishin ndërmarrë me dashje, ai është përgjegjës dhe fajtor për këtë vepër penale.

- Vlerësimi i provave

Gjykata e ka marr të besueshme dëshminë e të dëmtuarit që ka dhënë për këtë rast në prokurori dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor. Së pari, i dëmtuari ka qenë dëshmitar okular, përveç se e ka pa ngjarjen edhe e ka përjetuar atë drejtpërdrejt si i dëmtuar. Kjo rrethanë na jep të kuptojmë se i dëmtuari e ka përjetuar dhe perceptuar deri në detaje ngjarjen që ka ndodh më datën 09.04.2011. Gjithashtu, i dëmtuari e ka identifikuar të pandehurin menjëherë pas ngjarjes dhe i ka përshkruar veprimet e tij. Së dyti, i dëmtuari në dëshmitë e tij, ka qenë konsistent gjatë përshkrimit të fakteve kryesore që lidhen me rrethanat e çështjes dhe s'kemi vërejt ndonjë ndryshim në dëshmitë e tij. Në të dy dëshmitë e tij, ka pohuar se ditën e ngjarje i pandehuri e kishte sulmuar dhe goditur me thikë. Për më tepër, për faktet kryesore dëshmitë e tij përputhen me provat materiale, siç janë;

raportet mjekësore, raportet policore, foto- dokumentacionin e vendit të ngjarjes si dhe akt ekspertimi mjeko-ligjor.

Dëshmia e të dëmtuarit, përveç se është e detajuar, ka dhënë një pasqyrë të saktë të ngjarjes dhe rrethanave që quan në sulmin me thikë nga i pandehuri. Ai ka shpjeguar qartë se çfarë kishte ndodhur para dhe gjatë incidentit, si dhe ka sqaruar se nuk kishte asnjë lidhje me vajzën për të cilën i pandehuri pretendonte. Prandaj, kjo dëshmi ka ndihmuar për të kuptuar edhe motivin e sulmit ndaj të dëmtuarit.

Gjykata i mori të besueshme provat materiale, të cilat janë administruar dhe janë marrë për bazë në këtë rast. Sa i përket raporteve mjekësore mbi mjekimin e të dëmtuarit, vlerësojmë se ato janë të besueshme, të ligjshme dhe me vlerë provuese, pasi janë lëshuar nga organet kompetente mjekësore, janë të protokolluara dhe të vulosura. Gjithashtu, raportet në fjalë janë lëshuar nga institucionet publike shëndetësore, lidhur me kohën e mjekimit të të dëmtuarit.

Sipas vlerësimeve të kësaj Gjykate, raportet mjekësore provojnë faktet kryesore lidhur me dëmtimet trupore që ka pësuar i dëmtuari, mjetet me të cilat janë shkaktuar ato, si dhe llojin dhe natyrën e tyre. Përmes raporteve mjekësore të përshkruara më lart në këtë aktgjykim, provohet se i pandehuri ka pësuar lëndime trupore dhe llojin e tyre. Po ashtu, janë pasqyruar natyra e lëndimeve, shkalla dhe rrezikshmëria në çastin e shkaktimit.

Për më tepër, palët nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim të veçantë lidhur me ligjshmërinë dhe vlerën provuese të raporteve mjekësore.

Gjykata ia ka falur besimin dëshmisë – akt ekspertimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore, për sa i përket gjetjeve dhe përfundimeve lidhur me llojin, natyrën, shkallën dhe rrezikshmërinë e lëndimeve trupore që ka pësuar i dëmtuari. Sipas vlerësimit të gjykatës, mendimi dhe konstatimi i ekspertëve përputhen plotësisht me provat materiale dhe raportet mjekësore për të dëmtuarin.

Mendimi dhe konstatimi i ekspertëve në aktin e ekspertimit janë të besueshëm edhe për faktin se janë mbështetur dhe bazuar në dokumentacionin mjekësor mbi mjekimin e të dëmtuarit. Për më tepër, në aktin e ekspertimit janë dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me të gjitha pyetjet që janë shtruar në urdhrin për ekspertim mjeko-ligjor.

Gjykata rikujton se, sipas nenit 5 të Ligjit për Mjekësinë Ligjore, përcaktohet se ekzaminimet klinike mjeko-ligjore, siç janë përcaktimi i mjetit, shkalla e lëndimeve trupore, humbja e aftësisë për punë, mund të kryhen vetëm nga mjeku ligjor.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të pandehurit ne përputhje me nenin 119 paragrafi 5 të KPP-së. Sipas vlerësimit, një pjesë e mbrojtjes së tij është e besueshme, ndërsa pjesa tjetër jo. Si të besueshme është pranuar mbrojtja e tij që pranon se ditën kritike është takuar me të dëmtuarin dhe se e ka sulmuar me thikë. Ndërsa, gjykata nuk e ka pranuar mbrojtjen e tij, pasi ai ka theksuar se gjatë momentit të ngjarjes nuk e ka ditur se çfarë po bënte, siç ka thënë ai: "kam humbur kontrollin". Kjo, për arsye se ditën kritike i pandehuri ishte i armatosur me thikë, e kishte ftuar të dëmtuarin për t'u takuar dhe e kishte dërguar në parkun e qytetit, larg pranisë së njerëzve. Aty, në befasi, e kishte sulmuar disa herë me thikë. Këto rrethana qartë e rrezojnë pretendimin e të pandehurit dhe tregojnë se ai e kishte përgatitur sulmin ndaj të dëmtuarit deri në detaje.

- Pretendimet e mbrojtësit;

Mbrojtësja ka pretenduar se te i pandehuri nuk ka ekzistuar dashja për kryerjen e veprës penale, pasi i pandehuri me të dëmtuarin kanë qenë shumë pranë njëri tjetrit dhe nëse do të ekzistonte dashje i pandehuri ka pasur mundësi ta kryente këtë vepër penale.

Gjykata ka refuzuar pretendimin e mbrojtjes se i pandehuri nuk ka pasur qëllim e as dashje për ta privuar nga jeta të dëmtuarin. Gjykata thekson se, sipas nenit 22 të Kodit të Procedurës Penale, dashja dhe qëllimi për kryerjen e një veprë penale mund të nxirren nga rrethanat e rastit konkret. Në këtë rast, dashja e të pandehurit mund të vërtetohet përmes veprimeve të tij konkrete.

Sipas dëshmive të çështjes rezulton se ditën kritike, i pandehuri me telefon e kishte ftuar për një takim të dëmtuarin. Pastaj, pasi janë takuar sipas udhëzimeve të tij, ata kishin shkuar në parkun e qytetit dhe i pandehuri pa asnjë paralajmërim, e kishte sulmuar disa herë të dëmtuarin, duke e goditur në pjesë vitale të trupit, me çka i ka shkaktuar lëndime trupore. E gjithë ngjarja ka ndodhur pasi i pandehuri kishte dyshuar se i dëmtuari kishte ndërhyrë në lidhje që kishte i pandehuri me një vajzë, që e njihte edhe i dëmtuari. Prandaj, të gjitha këto rrethana, tregojnë se i pandehuri ishte i motivuar dhe përgatitur për rastin, paraprkisht ishte pajisur me thikë se e kishte ftuar të dëmtuarin takim, e kishte zgjedh vendin në parkun e qytetit, ku kishte pak njerëz dhe pastaj e kishte sulmuar me thikë të dëmtuarin disa herë në pjesët vitale të trupit duke i

shkaktuar lëndime trupore. Këto rrethana, në fakt, tregojnë edhe dashjen dhe qëllimin e të pandehurit për këtë veprë penale.

Gjykata ka refuzuar propozimin e mbrojtëses së të pandehurit, avokates Fatmire Braha, për nxjerrjen e një prove nga Psikiatria Forenzike, e cila kishte për qëllim të konstatohej gjendja mendore e të pandehurit në kohën e kryerjes së veprës penale.

Së pari, mbrojtja nuk ka paraqitur asnjë dëshmi konkrete që do të vërtetonte se i pandehuri ka pasur ndonjë sëmundje mendore apo çrregullim mendor në momentin e kryerjes së veprës penale. Mungesa e një baze faktike apo dokumentacionit përkatës mjekësor që do të mbështeste pretendimet e mbrojtjes ka çuar në refuzimin e kërkesës për nxjerrjen e provës së tillë. Sipas vlerësimit të gjykatës, çdo kërkesë për të verifikuar një element të tillë duhet të mbështetet në dëshmi konkrete dhe të vlefshme, të cilat në këtë rast mungojnë.

Së dyti, nxjerrja e një prove të tillë është e pamundshme, ose e vështirësuar, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nga momenti i kryerjes së veprës penale, rreth 14 vite më parë. Gjykata rikujton se për të vlerësuar gjendjen psikike të të pandehurit në atë periudhë, ka qene e nevojshme që ekzaminimi të bëhet në kohën kur ka ndodhur ngjarja, pasi një vlerësim i ngjarjeve shumë kohë pas ndodhës mund të ndikojë në saktësinë e konstatimeve.

Së treti, gjykata ka marrë parasysh një rast tjetër të përmendur nga mbrojtja, ku i është bërë një ekzaminim i pandehurit pas një veprë penale tjetër, e cila ka ndodhur më vonë. Sipas gjykatës, ky rast i referuar nga mbrojtja ka të bëjë me një ngjarje të ndryshme, për të cilën nuk mund të bëhet krahasim me rastin aktual. Në këtë mënyrë, trupi gjykues ka vlerësuar se përgjegjësia dhe gjendja psikike e të pandehurit duhet të vlerësohen individualisht për çdo rast veç e veç dhe nuk mund të lidhen me raste të tjera.

Gjithashtu, gjykata ka vlerësuar se gjatë gjykimit nuk janë vënë re shqetësime, probleme apo situata që mund të nxisnin dyshime mbi gjendjen mendore të të pandehurit. Për më tepër, nuk ka asnjë dëshmi që vërteton se ai ka vuajtur nga ndonjë problem shëndetësor psikiatrik, çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor.

Po ashtu, duhet theksuar se avokatja e të pandehurit e ka mbrojtur të pandehurin nga fillimi i procedurës dhe, deri në këtë moment, në fazat e mëhershme të shqyrtimit të çështjes, nuk ka parashtruar asnjë kërkesë për ekzaminimin e gjendjes mendore të të pandehurit. Ky fakt është i

rëndësishëm, pasi mbrojtja ka pasur mundësinë të kërkojë një ekzaminim të tillë që në fazat e hershme të procedurës, por nuk ka parashtruar asnjëherë një kërkesë të tillë deri tani.

Përfundimisht, gjykata ka vlerësuar se nxjerrja e një prove të tillë, e propozuar nga mbrojtja, është e vështirë dhe e pamundur për t'u realizuar. Për më tepër, mbrojtja nuk ka arritur të bëjë të besueshëm ekzistimin e fakteve që ka pretenduar, pasi kërkesa nuk është mbështetur me dëshmi konkrete, përveç pretendimeve të pabazuara dhe të paqarta. Për këto arsye, gjykata ka vendosur të refuzojë propozimin për ekzaminimin psikiatrik të të pandehurit, duke e konsideruar këtë kërkesë si të paarsyeshme dhe të paargumentuar.

- Matja dhe caktimi i llojit të dënimit

Lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, Gjykata ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 64 të Kodit Penal të Kosovës. Si rrethana rënduese janë vlerësuar: shkalla e lartë e dashjes së shprehur nga i pandehuri, përgjegjësia dhe përgjegjshmëria e tij të plotë, kontributi esencial në kryerjen e veprës penale, mënyra e kryerjes së veprës penale, rrezikshmëria e saj, si dhe rreziku i drejtpërdrejtë që është shkaktuar për jetën e të dëmtuarit, të cilit i janë shkaktuar lëndime trupore. Ndërsa, si rrethana lehtësuese janë vlerësuar dhe marrë për bazë fakti se i pandehuri ka treguar sjellje të mira dhe korrekte në gjykatë, se nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar një periudhë e gjatë (afërsisht 14 vite), dhe lëndimet që i ka shkaktuar të dëmtuarit kanë qenë të përkohshme për shëndetin e tij. Duke qenë se i pandehuri është i moshës së vjetër - para pensionit, si dhe për faktin që i pandehuri dhe familja e tij janë pajtuar me të dëmtuarin, të gjitha këto rrethana lehtësuese tregojnë se edhe me një dënim më të butë për të pandehurin mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Për më shumë, në këtë rast ligji parashikon mundësinë e zbutjes së dënimit nën minimumin e paraparë ligjor, pasi vepra penale ka ngelur në tentativë. Andaj, në përputhje me nenin 66, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 dhe 1.2 të KPK-së, për veprën penale "vrasje në tentativë", ndaj të pandehurit është aplikuar zbutja e dënimit nën minimumin e paraparë ligjor, meqë vepra penale ka mbetur në tentativë.

Krejt në fund, vlerësojmë se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është adekuat dhe në përputhje me të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të peshuara në këtë rast. Duke qenë të bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit, por edhe ndaj personave

të tjerë, dhe duke besuar që dënimet do të shërbejnë jo vetëm ndaj të pandehurit, por edhe si masë preventive për të tjerët.

- Llogaritja e paraburgimit

Sipas nenit 73 të Kodit Penal të Kosovës, parashikohet që koha e kaluar në paraburgim, si dhe çdo periudhë e heqjes nga liria që është e lidhur me veprën penale, llogariten si pjesë e dënimit të shqiptuar me burgim, burgim afatgjatë, ose me dënim me gjobë. Në përputhje me këtë dispozitë ligjore, Gjykata ka përfshirë kohën e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak si pjesë të dënimit me burgim të shqiptuar ndaj të pandehurit.

- Lidhur me shpenzimet e procedurës penale:

Gjykata ka vendosur ta obligojë të pandehurin të paguajë shpenzimet e procedurës penale, deri në shumën e shpenzimeve të shkaktuara. Ky vendim është marrë në përputhje me nenin 450, paragrafi 1 dhe nenin 452, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, pasi është konstatuar fajësia e të pandehurit me këtë aktgjykim.

- Kërkesa pasurore juridike:

Në lidhje me kërkesën pasurore juridike, Gjykata nuk ka marrë një vendim, pasi pala e dëmtuar ka hequr dorë nga kjo kërkesë gjatë gjykimit.

Nga ato që u tha më lart, u vendos siç është përcaktuar në dispozitivin e aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.38/2011 datën 17.03.2025

Procesmbajtësja:

Edita Kelmendi

Kryetari i trupit gjykues, gjyqtari:

Avni Mehmeti

KËSHILLË JURIDIK: Kundër aktgjykimit, pala ka të drejtë të paraqesë ankesë brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh, e cila fillon të llogaritet nga data e pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa duhet të dorëzohet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, duke dorëzuar kopje të mjaftueshme për të gjitha palët përkatëse.